

VENDIM
Nr. 228, datë 29.2.2012

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË
PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR
TIRANË-ELBASAN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Tiranë-Elbasan.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për sipërfaqe, tokë bujqësore dhe truall, prej 369 964 (treqind e gjashtëdhjetë e nëntë mijë e nëntëqind e gjashtëdhjetë e katër) m², me vlerë të përgjithshme 181 624 813 (njëqind e tetëdhjetë e një milionë e gjashtëqind e njëzet e katër mijë e tetëqind e trembëdhjetë) lekë, objekte, me vlerë 157 232 702 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë milionë e dyqind e tridhjetë e dy mijë e shtatëqind e dy) lekë, me një vlerë të përgjithshme shpronësimi prej 338 857 515 (treqind e tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekësh.

4. Shpenzimet procedurale, në vlerën 10 165 000 (dhjetë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e pesë mijë) lekë, do të përballohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve.

5. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 338 857 515 (treqind e tridhjetë e tetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekësh, të përballohet si më poshtë:

a) 214 557 515 (dyqind e katërmëdhjetë milionë e pesëqind e pesëdhjetë e shtatë mijë e pesëqind e pesëmbëdhjetë) lekë, nga “Llogaria e veçantë” e Ministrisë së Financave pranë Bankës së Shqipërisë “Fondi i shpronësimeve”;

b) 124 300 000 (njëqind e njëzet e katër milionë e treqind mijë) lekë, nga zëri “Investime”, miratuar për Drejtorinë e Përgjithshme e Rrugëve, për vitin 2012.

6. Shpronësimi të fillojë më 1.4.2012.

7. Për objektin “Banesë 2kt”, për të cilin në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Leje ndërtimi”, pronari do të kompensohet, për efekt shpronësimi, pasi të ketë kryer procedurat e regjistrimit dhe në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

8. Për objektet, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces legalizimi”, poseduesit e këtyre objekteve do të kompensohen, për efekt shpronësimi, nga Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.

9. Për objektet, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

10. Për pasuritë, për të cilat në kolonën “Shënime” janë bërë shënimet “Proces verifikimi dhe regjistrimi” dhe “Proces saktësimi dhe regjistrimi”, pronarët respektivë do të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojnë proceset e verifikimit, saktësimit dhe regjistrimit nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, si dhe në bazë të dokumentacionit të plotë dhe të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

11. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Proces regjistrimi”, pronarët respektivë do të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të përfundojë procesi regjistrimit dhe në bazë të dokumentacionit të plotë e të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve.

12. Për të dyja këto kategori të trajtuara në pikat 10 dhe 11 të këtij vendimi, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, para likuidimit të pronarëve, do të mbajë përsëri korrespondencë me zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për të vërtetuar përfundimin e proceseve respektive.

13. Për pasuritë, për të cilat në kolonën përkatëse është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, pronarët përkatës do të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë e të rifreskuar të pronësisë, që do të dorëzojnë pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rugëve.

14. Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve do të bëjë likuidimet e pronarëve në bazë të pikave 7, 8, 9, 10, 11, 12 dhe 13 të këtij vendimi.

15. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë dhe Elbasan brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rugëve, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’i vihet në dispozicion nga Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, dhe të bëjë kalimin e pronësisë, për pasuritë e shpronësuara, në favor të shtetit.

16. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, Tiranë dhe Elbasan, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale, si dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

17. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Drejtoria e Përgjithshme e Rugëve, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha